

VENDIM
Nr. 237, datë 22.9.2022

**MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “EZ-5 ENERGY” SHPK, NË VEPRIMTARINË E
PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA CENTRALI FOTOVOLTAIK, ME
KAPACITET TË INSTALUAR 10 MW, ME VENDNDODHJE NË ZONËN
KADASTRALE NR. 3038, FSHATI POVELÇË, NJËSIA ADMINISTRATIVE
DËRMENAS, BASHKIA FIER, QARKU I FIERIT**
(Ndryshuar me vendimin nr. 100, datë 9.4.2026)

(i përditësuar)

Në mbështetje të neneve 16, nenit 37, pika 2, germa “a”, dhe nenit 38, pika 2, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 4, pika 1, germa “a”, nenit 5, pika 1, germa “a” dhe nenit 10, pika 3 të rregullores “Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin/njohjen ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, e ndryshuar; si dhe nenit 15 dhe nenit 19, pika 1, germa “a”, të rregullores “Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 22.9.2022, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes me nr. 1539/4 prot., datë 19.9.2022, “Mbi licencimin e shoqërisë ‘EZ-5 Energy’ sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaike, me kapacitet të instaluar 10 mw, me vendndodhje në zonën kadastrale nr. 3038, fshati Povelçë, Njësia Administrative Dërmenas, Bashkia Fier, qarku i Fierit”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 202, datë 10.8.2022 vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “EZ-5 Energy” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali gjenerues i energjisë elektrike fotovoltaike, me kapacitet të instaluar 10 mw, për një afat 25-vjeçar.

- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure në datat 12.8.2022 dhe 13.8.2022 dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 25.8.2022), nuk rezultoi të ketë të tilla.

- Me shkresën nr. 1387/1 prot., datë 18.8.2022, ERE iu drejtua shoqërisë “EZ-5 Energy” sh.p.k. për ta njoftuar mbi fillimin e procedurës, nisur me vendimin e Bordit nr. 202/2022 dhe dokumentacionin e konstatuar të munguar apo të plotësuar pjesërisht.

- Shoqëria ka depozituar dokumentacion plotësues të aplikimit me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1387/3 prot., datë 25.8.2022. Pas shqyrtimit të dokumentacionit, rezultoi se mbetej ende informacion/dokumentacion pa plotësuar, ERE iu drejtua shoqërisë me shkresën nr. 1387/5 prot., datë 12.9.2022 për plotësimin e tij. Në vijim shoqëria “EZ-5 Energy” sh.p.k. ka depozituar dokumentacion plotësues me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1387/6 prot., datë 13.9.2022.

- ERE me shkresën nr. 1387/2 prot., iu drejtua dhe Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), duke i kërkuar informacion mbi nënshkrimin e kontratës përkatëse me shoqërinë “EZ-5 Energy” sh.p.k., sikurse përcaktohet në vendimin e Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 417, datë 15.6.2022 “Për miratimin e ndërtimit të centralit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike dhe veprave ndihmëse, i cili nuk është objekt koncesioni, në zonën kadastrale nr. 3038, fshati Povelçë,

Njësia Administrative Dërmenas, Bashkia Fier, qarku i Fierit, nga shoqëria “EZ-5 Energy” sh.p.k.” dhe sqarim në lidhje me krijimin e shoqërisë për qëllime të veçanta, të parashikuar në këtë VKM.

- MIE ka kthyer përgjigje me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1387/4 prot., datë 31.8.2022, ku është shprehur se në zbatim të VKM-së nr. 417, datë 15.6.2022, ka nënshkruar kontratën përkatëse me shoqërinë “EZ-E Energy” sh.p.k., si dhe ka specifikuar se referuar pikës 1, germa “iii” të VKM-së nr. 417/2022, krijimi i shoqërisë për qëllime të veçanta është një e drejtë dhe jo detyrim i shoqërisë “EZ-5 Energy” sh.p.k.

- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit për t’u pajisur me licencë në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, në zbatim të aneksit A, të rregullores “Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin/njohjen ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, e ndryshuar.

- Dokumentacioni i këtij aplikimi është tërësisht i plotësuar.

- ERE, në zbatim të nenit 38, pika 1, germa “a”, të ligjit “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, dhe nenit 5, të rregullores “Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin/njohjen ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” të ndryshuar, lëshon një licencë për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike deri në 30 vjet, por duke qenë se nga studimi i fizibilitetit për ndërtimin e impiantit fotovoltaiik 10 mw rezulton se jetëgjatësia e burimit është 25 vjet, atëherë ERE kushtëzohet nga kjo jetëgjatësi në dhënien e afatit maksimal për këtë licencë fotovoltaike, deri në 25 vjet.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë¹ “EZ-5 Energy” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali gjenerues i energjisë elektrike fotovoltaike, me kapacitet të instaluar 10 mw, për një afat 25-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

¹ Vendimi nr. 100, datë 9.4.2026 në pikën 1 shprehet;

“ 1. Të modifikojë licencën e shoqërisë “EZ-5 Energy” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 237, datë 22.9.2022, për prodhimin e energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiik me kapacitet të instaluar 10 mw, duke shtuar veprat ndihmëse/njësitë e depozitimit të energjisë elektrike në aneksin A të licencës, pa ndryshuar kapacitetin total të instaluar.”